PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

RAPORT VJETOR

2020

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

P Ë R M B A J T J A

FJALA E DREJTORES

FAKTE MBI PUNËN TONË NË 2020

BORDI I DREJTORËVE DHE EKIPI

AKTIVITETI SIPAS FUSHAVE PROGRAMATIKE

PUBLIKIMET

PUNA JONË NË FOKUSIN E MEDIAS

MBËSHTETËSIT

FINANCAT

TË RINJTË
PËR TË
ARDHMEN
FORMIM
ORIENTIM
PUNËSIM
LEVIZ
Albania

FJALA E DREJTORES

Të nderuar kolegë, partnerë dhe institucione mbështetëse,

Ky raport përfshin punën e bërë gjatë një viti të paprecedent, gjatë të cilit bota u përball me sfidën më të madhe në njëqind vitet e fundit, pandeminë e Covid-19. Sistemet qeverisëse dhe ekzistenca jonë individuale u ndikuan rëndë dhe u kërcënuan në kaq shumë nivele.

Tek Partnerët Shqipëri, si në shumë organizata dhe institucione anembanë globit, shqetësimi ynë i parë ishte siguria e stafit dhe gjetja e mënyrës më të mirë për t'i mbështetur ata në sfidën e punës dhe pasigurive individuale e familjare.

Si një ekip u bashkuam për të mbështetur njëri-tjetrin në këto kohë të vështira emocionalisht, por edhe për të mbështetur përfituesit tanë, nga përfituesit e granteve të OJF-ve te sipërmarrjet sociale, e sektori jo-fitimprurës në tërësi. Ne arritëm të përshtasim menjëherë të gjitha detyrimet kontraktuale me palët e treta duke faktorizuar sfidat e situatës. Në shumë raste, kjo u bë e mundur edhe falë fleksibilitetit dhe mirëkuptimit të donatorëve dhe mbështetësve.

Duke qenë një organizatë mbështetëse, ne ndjemë përgjegjësinë për t'u mobilizuar menjëherë në identifikimin e sfidave të sektorit dhe për të hartuar një përgjigje të shpejtë në lehtësimin e tyre, vetëm tre javë pasi kaluam në një mbyllje të plotë. Pjesë e paketës së Partnerëve Shqipëri ishte qasja falas në platformën Zoom për më shumë se 100 OJF, në mënyrë që ata të mos ndalonin ofrimin e shërbimeve dhe komunikimin me përfituesit, krahas trajnimit dhe asistencës individuale në përshtatjen e ofrimit të shërbimeve ekzistuese dhe atyre të reja duke përdorur një larmi platformash online dhe mjetesh digjitale.

Ne i drejtuam një thirrje publike komunitetit të donatorëve brenda dhe jashtë vendit, për të treguar fleksibilitet në procedura dhe një shtim të fondeve për sektorin jofitimprurës në Shqipëri, për të mbështetur përpjekjet e tij në adresimin e sfidave në lidhje me Covid-19.

Viti 2020 ka qenë testi më i madh i rezistencës që mund të kemi imagjinuar ndonjëherë për ne si individë, institucionet që punojmë e drejtojmë, sistemet e ofrimit dhe të manaxhimit të shërbimeve që kemi krijuar.

Dhe unë jam shumë krenare të shoh se si kemi bërë më të mirën për t'u përballur me sfidat dhe për t'i adresuar ato, ndërsa janë akoma të pranishme.

Duke lexuar raportin tonë vjetor, shpresoj të vlerësoni përpjekjen e ekipit për të ruajtur rëndësinë e punës sonë në mbështetje të shoqërisë civile, monitorimin dhe lehtësimin e dialogut të politikave me institucionet, krahas me nismat advokuese për zhvillime të rëndësishme legjislative që ndikojnë sektorin.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja jonë ndërkombëtare në forume të politikave u intensifikua gjithashtu si një mënyrë për të fituar mbështetje dhe njohje për çështjet e ngutshme me të cilat po përballej sektori i shoqërisë civile në Shqipëri për shkak të Covid-19. Puna jonë pioniere në ripërdorimin social të pronave të konfiskuara mori njohje ndërkombëtare dhe zhvillimet në fushën e filantropisë dhe sipërmarrjes sociale u konsoliduan më tej.

Ne vlerësuam të punuarit online dhe rritjen e njohjes së përdorimit digjital si një mundësi për të përshpejtuar axhendën tonë digjitale. Partnerët Shqipëri punoi për zhvillimin e një platforme inovatore për start-upet në Ballkan, të quajtur Dua Partners Invest, e cila u lançua në fillim të vitit 2021. Kjo platformë po mundëson gjithashtu Partnerët Shqipëri të shmangin përdorimin e materialeve të shtypura, duke adresuar kështu angazhimin tonë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet rregullimit të të gjitha marrëdhënieve me palët e treta përmes një sistemi të centralizuar online.

Për ta mbyllur, unë ndjej më shumë se çdo herë tjetër, të shpreh mirënjohjen time për stafin tonë të jashtëzakonshëm dhe të përkushtuar që demonstroi se ishte në lartësinë e duhur për tu përballur me sfidat e kohës, organizatat dhe partnerët tanë të palodhur, rrjetet që kanë qenë gjithmonë të pranishëm për ne në kohë të vështira por jo vetëm, dhe donatorët e mbështetësit tanë që vlerësojnë punën dhe besojnë në profesionalizmin tonë.

Sinqerisht,

Juliana Hoxha
Drejtori

TË RINJTË
PËR TË
ARDHMEN
FORMIM
ORIENTIM
PUNËSIM
LEVIZ
Albania

BORDI I DREJTORËVE

Kryetar
Neritan Kallfa

Përgjegjëse thesari
Mirjeta Emini

Sekretare
Klodiana Kapo

Anëtare
Alketa Skëndaj

Anëtare
Elira Sakiqi

EKIPI

Drejtore
Juliana Hoxha

Manaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore
Arjola Agolli

Drejtore e Programeve
Klotilda Kosta

Drejtore e Programeve
Jonida Alite

Manaxhere e Komunikimit
Elona Kapexhiu

Manaxhere e Financës
Jetmira Hysenaj

Manaxhere Programi
Kostandina Keruti

Manaxhere Projekti
Maris Selamaj

Manaxhere Projekti
Xhoana Zeqo

Manaxhere Projekti
Ardiola Alikaj

Manaxhere e Granteve
Ariola Memia

Manaxhere e Prog. të Granteve– Levizalbania
Iris Panariti

Manaxhere e Granteve Individuale – Levizalbania
Eriona Kaceli

Asistente Programi
Kristina Lato

Asistente Programi
Era Sherifaj

Asistente e Zyrës
Ana Zenelaj

Logjistik
Artan Sauku

Mirëmbajtje
Mare Paplekaj

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

FAKTE MBI PUNËN TONË NË 2020

Fakte

146 DITË — TRAJNIME & WORKSHOPE

200 DITË — SESIONE MENTORIMI

9 DITË — EVENTE PUBLIKE

38 DITË — AKTIVITETE TË TJERA

Sesione Informimi, Fokus Grupe, Takime me Komunitetin, Tryeza të Rrumbullakëta, Sesione Rrjetëzimi, Forume, etj.

393 DITË AKTIVITETE

Përfituesit

2,310

3,036 PJESËMARRËS DIREKT

726

50 Dalje në media

30 PUBLIKIME

RAPORTE
BROSHURA
MANUALE
UDHËZUES
GAZETA
STUDIME

Grante

- Anti-korrupsioni dhe Qeverisja Transparente
- Sipërmarrja
- Mbrojtja e Mjedisit
- Media
- Përfshirja Sociale e Grupeve të Margjinalizuara



*Skema financiare të menaxhuara direkt nga Partnerët Shqipëri, pa përfshirë projektet LevizAlbania dhe RisiAlbania të cilët operojnë si entitete të veçanta.

375,000 EURO

34 Grante **të akorduara**

Përfaqësimi

23 Projekte

24 Konsulentë

14 Donatorë

24 Organizata Partnere

LOKAL

RAJONAL

GLOBAL

REAGIMI I PARTNERËVE SHQIPËRI NDAJ EMERGJENCËS COVID-19

Thirrje drejtuar komunitetit donator
Partnerët Shqipëri paraqitën një thirrje publike drejtuar komunitetit donator, që të vazhdojnë të mbështesin sektorin jo-fitimprurës dhe të tregojnë fleksibilitet dhe adaptim në përputhje me situatën, konsideruar distancimin fizik dhe nevojën për ndryshime në strategjitë apo riorientimin e programeve në adresimin e nevojave dhe çështjeve që lidhen me situatën COVID-19.

Vlerësim i nevojave të sektorit të OJF-ve në kushtet e emergjencës COVID-19
Gjatë javës së 23 marsit, Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri kryen një vlerësim të shpejtë për të parë impaktin e situatës në veprimtarinë e sektorit, nevojat lidhur me adaptimet kontraktuale me donatorët për aktivitetet në vijim, si dhe nevojat specifike lidhur me aksesin dhe aftësitë për të orientuar ofrimin e shërbimeve online.

Paketë mbështetëse për sektorin në kushtet e emergjencës COVID-19
Informacioni i mbledhur nga Vlerësimi i Nevojave të Sektorit u përdor nga Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile për hartimin dhe vënien në zbatim të një pakete mbështetëse për sektorin e cila konsistoi në ofrimin e trajnimeve për njohjen dhe përdorimin e platformave të bashkëpunimit online për 76 përfaqësues të OJF-ve të interesuara, si dhe vënien në dispozicion falas të platformës ZOOM për 1 vit, për 41 organizata në Shkodër, Fushë-Arrëz, Tropojë, Dibër, Tiranë, Durrës, Lushnje, Vlorë, Elbasan, Librazhd, Berat, Gjirokastër, Përmet dhe Sarandë, të cilat punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të turizmit dhe bujqësisë, qeverisjes së mirë, edukimit, ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar, gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të rinjtë, grupet e margjinalizuara etj.

Që prej ofrimit të përdorimit falas të platformës ZOOM, organizatat përfituese kryen më shumë se 100 trajnime, 150 takime me aktorë të ndryshëm dhe grupe interesi dhe ofruan rreth 40 shërbime të tjera online si sesione informimi dhe seanca këshillimi për grupet të cilave u shërbejnë.




PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Mbështetje Sektorit Jo-Fitimprurës për t'u Përshtatur me Emergjencën Covid-19

Raport Vlerësimi









QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

Si një pjesë integrale e Partnerëve Shqipëri, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile (QKB) gjatë vitit 2020 ka konsoliduar më tej rolin e saj si një platformë infomimi, ndërtimi kapacitetesh, rrjetëzimi dhe advokimi në sektor.

QKB organizoi mbi 160 aktivitete të ndërtimit të kapaciteteve si programe rajonale trajnimi, seanca mentorimi, dhe programin e Akademisë së OJF-ve për më shumë se 900 përfaqësues të OSHC-ve në të gjithë vendin.

124 OJF dhe grupe joformale u asistuan përmes shërbimeve informuese të QKB-së, dhe 8 rrjete dhe koalicione prej rreth 78 OShC u forcuan përmes një programi të përshtatur të ndërtimit të kapaciteteve, për një ndikim më të madh të iniciativave të tyre dhe avancimin e kauzave për të cilat ata advokojnë.

131 OSHC u përfshinë në iniciativa advokuese për çështje prioritare të sektorit, për një mjedis më mundësues ligjor dhe praktik.

106 OShC u angazhuan në takime konsultuese për Kodin e Standardeve për OJF-të, një mekanizëm vetërregullues për sektorin që synon të përmirësojë efektivitetin e punës së organizatave jofitimprurëse, qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien.









INICIATIVA ADVOKUESE NË MBËSHTETJE DHE ME PJESËMARRJEN E SEKTORIT



Reagimi i organizatave të shoqërisë civile në lidhje me projektligjin për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse

Më 10 qershor, Ministria e Drejtësisë publikoi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, projektligjin "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore nisën menjëherë një proces konsultimi me organizatat e shoqërisë civile për të diskutuar projektligjin dhe për të dalë me rekomandime konkrete në lidhje me të. Përmes një letre të hapur drejtuar institucioneve përgjegjëse për hartimin e ligjit, si dhe donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare në vend, 27 organizata të shoqërisë civile pjesë e procesit të konsultimit, shprehën shqetësimin e tyre për projektligjin dhe ofruan mendimin dhe rekomandimet e tyre në parim dhe nen për nen.

Ministria e Drejtësisë iu përgjigj pozitivisht kërkesës. Takimi u zhvillua dhe komentet dhe sugjerimet e OShC-ve u mirëpritën, por në vijim MD nuk dërgoi asnjë informacion ose reagim mbi ndryshimet në projektligj dhe arsyet për mos marrjen parasysh të shumicës së rekomandimeve.

Kërkesë në Parlament për një seancë dëgjimore mbi projektligjin

Dorëzimi i projektligjit nga Qeveria në Parlament u shoqërua me një mungesë të plotë informacioni dhe transparence mbi ndryshimet e bëra pas konsultimit me OSHC-të dhe institucionet e tjera që kanë një rol vendimtar në zbatimin e këtij Ligji.

Në emër të grupit të OShC-ve, një kërkesë për një seancë dëgjimore iu dërgua Parlamentit në Tetor, për të paraqitur problematikat kryesore të Projektligjit në parim, dhe hapjen e një debati të gjerë me sektorin dhe të gjitha institucionet zbatuese.

Konsultim me organizatat e shoqërisë civile për projektligjin e ri për prokurimin publik

Prej vitesh, si pjesë e punës së saj për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile, Partnerët Shqipëri ka kontribuar dhe advokuar për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zhvillimin e praktikave të prokurimit social. Në shkurt '20, Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore drejtuan një proces konsultimi me shoqërinë civile mbi projektligjin e ri për prokurimin publik. Kontributi nga organizatat iu prezantua Drejtores së Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) në një takim të organizuar për këtë qëllim.

Ligji i ri i miratuar në Dhjetor 2020 lejon OShC-të të përfshihen në prokurim publik, gjë që shënon një zhvillim pozitiv për veprimtarinë e OShC-ve, veçanërisht për ato që ofrojnë shërbime.

Opinion mbi Projektligjin "Për regjistrin qendror të llogarive bankare"

Në tetor, krahas ndryshimeve të tjera në kuadrin ligjor rregullator të veprimtarisë së sektorit, organizatat e shoqërisë civile u njohën me nismën ligjore të qeverisë "Për regjistrin qendror të llogarive bankare". Ky projektligj është pjesë e një serie zhvillimesh ligjore që kanë ndodhur në 18 muajt e fundit, me një efekt të drejtpërdrejtë në organizimin dhe funksionimin e sektorit, si pjesë e masave parandaluese kundër financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave.
Pavarësisht afateve të ngushta të konsultimit, një grup i OJF-ve nën udhëheqjen e Qendrës Kombëtare Burimore, shqyrtuan draftin dhe paraqitën një seri rekomandimesh si pjesë e opinionit të tyre ligjor në Ministrinë e Financave.
Megjithë mungesën e transparencës në këtë proces konsultimi, pas miratimit të Ligjit u vu re se disa rekomandime të rëndësishme ishin reflektuar në ligjin aktual.

Konferencë Kombëtare e Shoqërisë Civile në Shqipëri

Më 4 dhjetor 2020, Qendra Kombëtare Burimore organizoi Konferencën Kombëtare të Shoqërisë Civile në Shqipëri.

Konferenca mblodhi së bashku mbi 130 përfaqësues të organizatave, rrjeteve dhe aktivistë të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore, donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare, për të diskutuar mbi çështje të zhvillimit të sektorit dhe rolit të tij në politikëbërje, forcimin e demokracisë dhe zhvillimin social-ekonomik të vendit.

E organizuar në dy sesione kryesore, në panelin hyrës, konferenca ofroi një panoramë të përgjithshme të zhvillimit të sektorit në tre aspekte:
(1) Tkurrja e hapësirës për shoqërinë civile, mjedisi mundësues dhe roli i sektorit në rrugën drejt anëtarësimit në BE;
(2) Shteti i së drejtës, demokracia dhe pjesëmarrja në hartimin e politikave dhe proceset legjislative, dhe
(3) Të drejtat themelore, liria e shprehjes dhe mediave, për të vijuar më pas në tre diskutime tematike, që eksploruan më tej problemet kryesore, sfidat dhe perspektivat e çështjeve të paraqitura si pjesë e panelit kryesor.

Në sesionin e dytë të Konferencës "HAPËSIRË DISKUTIMI", organizatat patën mundësinë të zhvillonin diskutime rreth çështjeve më prioritare në sektorët ku punojnë. Tetë workshope tematike të udhëhequra nga organizatat propozuese hulumtuan mënyrat e bashkëpunimit për të çuar përpara çështjet dhe dialogun me institucionet dhe aktorët e tjerë.

Një përmbledhje e fjalëve dhe diskutimeve në panele, si dhe diskutimeve dhe rekomandimeve në workshopet tematike u ndanë gjerësisht me të gjithë aktorët.

Konsultime me OSHC-të mbi përgatitjen e IPA III
Në korrik, pas thirrjes së Komisionit Evropian për pjesëmarrje të organizatave të shoqërisë civile në procesin e përgatitjes së IPA III, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri promovoi gjerësisht thirrjen dhe organizoi një konsultim me OSHC-të mbi procesin dhe kuadrin e programimit të IPA III. OSHC-të ofruan sugjerime në lidhje me tematikën e prioriteteve si dhe procesin e zbatimit të IPA III.
Dokumenti me reagimet dhe sugjerimet e OSHC-ve iu dërgua Komisionit Evropian dhe Projektit të Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO 3) i cili koordinon procesin e mbledhjes së feedback-ut në nivel rajonal (Ballkani Perëndimor dhe Turqi).

Zhvillimi i vullnetarizmit dhe krijimi i një mjedisi mundësues ligjor

Qendra Kombëtare Burimore në bashkëpunim me shoqatën Përtej Barrierave filloi një diskutim të gjerë sektorial mbi vullnetarizmin dhe mjedisin mundësues për zhvillimin e tij në Shqipëri. Një seri takimesh dhe tryezash me përfaqësues të OShC-ve u zhvilluan gjatë vitit 2020, për të identifikuar problemet dhe sfidat me të cilat përballen organizatat dhe grupet informale gjatë zbatimit të kornizës ligjore për vullnetarizmin.

Katër vjet pas miratimit të Ligjit 45/2016 "Për Vullnetarizmin", i cili rregullon këtë fushë dhe shërbimin vullnetar në vend, zbatimi i tij ka mbetur prapa dhe ligji nuk po fiton terren për njohje si nga organizatat e shoqërisë civile, ashtu edhe nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij.
Në korrik, 40 OSHC dhe rrjete të organizatave të shoqërisë civile i drejtuan një letër të hapur institucioneve të zbatimit të ligjit dhe të gjithë partnerëve dhe mbështetësve ndërkombëtarë, duke theksuar shqetësimet dhe sfidat në zbatimin e tij.

Dialogu që filloi me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive si një nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, do të vijojë në 2021 në nivel ministror, për të diskutuar aksione konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor për vullnetarizmin në Shqipëri.

MATRICA E MONITORIMIT TË MJEDISIT MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE - RAPORTI PËR SHQIPËRINË



Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me Qendrën Burimore për Shoqërinë Civile përgatiti dhe publikoi Raportin e Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile për vitin 2019.

Raporti evidentoi se edhe pse ka patur iniciativa për përmirësimin e mjedisit mundësues, siç ishte rishikimi i Udhëzuesit të Hartimit të Politikave dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, apo përgatitja dhe publikimi i udhëzimit mbi procedurën e rimbursimit të TVSH-së rreth fondeve të donatorëve të huaj për OSHC-të, gjatë 2019 u vu re një tendencë për rritje të kontrollit të institucioneve shtetërore mbi veprimtarinë e OSHC-ve. Kjo, përmes miratimit të ligjeve mbi paketën e parandalimit të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parasë, ligji për rininë, apo paketa ligjore për ndërmarrjet sociale.

Strategjitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit Shtet – OSHC (Udhërrëfyesi për Shoqërinë Civile dhe Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile) nuk dhanë rezultate drejt përmirësimit të mjedisit mundësues. Problematika të tjera të rëndësishme, sic ishte miratimi i paketës ligjore kundër shpifjes pavarësisht reagimeve të organizatave kombëtare e ndërkombëtare, apo proçeset konsultuese të cilat ende nuk konsiderohen nga institucionet shtetërore si një mjet për përmirësimin e dokumentave bazuar në rekomandimet e OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit, janë ndër gjetjet e raportit.

Raporti për Shqipërinë është pjesë e një serie raportesh në shtatë vende të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të projektit "Protecting Civic Space – Regional Civil Society Hub" financuar nga Agjencia Suedeze për bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA) dhe zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, pjesë e të cilit është Partnerët Shqipëri.

KODI I STANDARDEVE PËR OJF-TË

Gjatë vitit 2020, Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore udhëhoqën punën për hartimin e Kodit të Standardeve për OShC-të, një iniciativë e hershme e Partnerëve Shqipëri e cila u ri-prezantua në sektor vitin e kaluar. Kodi i Standardeve është një mekanizëm vetërregullues për sektorin, që synon të përmirësojë efektivitetin e punës së organizatave jofitimprurëse, qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien.



PSH organizoi 7 forume lokale që sollën bashkë rreth 100 përfaqësues nga organizata në mbarë vendin, ku u diskutua mbi standardet aktuale të zbatuara përgjatë veprimtarisë së tyre, sfidat për të arritur dhe mbajtur këto standarde si dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm.

Ai është një tërësi parimesh dhe angazhimesh mbi mënyrën se si organizatat zhvillojnë veprimtarinë e tyre, si ato qeverisen, manaxhojnë burimet, janë transparente dhe llogaridhënëse me të gjithë grupet e interesit, si ndërtojnë marrëdhëniet me mbështetësit dhe donatorët, si manaxhojnë konfliktin e interesave, etj.

Konceptuar si kontribut i sektorit për sektorin, Kodi është një praktikë e ngritur dhe bazuar në përvoja dhe modele ndërkombëtare e rajonale të standardeve për organizatat e shoqërisë civile sikurse ajo e Rrjetit Ballkanik të Zhvillimit të Shoqërisë Civile (BCSDN) dhe Standardit Global për Përgjegjshmërinë e OSHC-ve.

Në Dhjetor '20, Partnerët Shqipëri filloi programin e fuqizimit të sektorit, duke ndihmuar OShC-të në rritjen e standardeve të tyre të punës, si dhe në përdorimin e metodave alternative të mbledhjes së fondeve, drejt një qëndrueshmërie më të madhe financiare dhe organizative. Programi i trajnimit do të pasohet nga asistencë individuale të përshtatur sipas nevojave në nivelin organizativ për të gjitha OSHC-të pjesëmarrëse.

"Act for Standards - Ndërtimi i besimit, llogaridhënies dhe qëndrueshmërisë në organizatat e shoqërisë civile" mbështetet nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë.

PROGRAME TRAINIMI DHE ASISTENCE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Në tetor, Partnerët Shqipëri nisi ofrimin e një programi asistence për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e projekteve të zbatuara nga dhjetë organizata nga mbarë vendi, përfitues të Programit të Granteve të Komisionit të Demokracisë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara. Programi konsiston në një seri trajnimesh dhe asistence teknike rreth çështjeve të zhvillimit organizativ, manaxhimit efektiv të projekteve, komunikimit efektiv me mbështetësit dhe përfituesit, dhe ndërtimin e fushatave advokuese efektive.



PROGRAMI I SHOQËRISË CIVILE PËR SHQIPËRINË DHE KOSOVËN

Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën është një program tre-vjeçar (2018-2021) i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, e përfaqësuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Prishtinë. Organizatë udhëheqëse për zbatimin e programit është Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me organizatë partnere Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

Programi synon të mbështesë pjesëmarrjen demokratike dhe zhvillimin e një shoqërie civile të fuqishme dhe aktive në Shqipëri dhe Kosovë, duke mbështetur OJF që çojnë përpara proçesin e anëtarësimit në BE përmes kontributit në njërën nga pesë fushat tematike, si më poshtë: Mos diskriminimi dhe barazia gjinore; Mediat e pavarura; Pakicat dhe grupet e margjinalizuara; Mbrojtja e mjedisit, dhe Lufta kundër korrupsionit.

Përfituesit e granteve të programit gjatë 2020

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) ka krijuar grupet e vetë-advokimit të personave me aftësi të kufizuara në katër qytete të Shqipërisë (Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë), të cilët po advokojnë në institucionet vendore dhe qendrore për të drejtat e tyre për përfshirje dhe jo-diskriminim. Raste të diskriminimit janë identifikuar përmes takimeve derë-më-derë dhe atyre në grup në komunitetet respektive dhe janë adresuar më tej me katër bashkitë dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Forumi i Mendimit të Lirë po punon për identifikimin dhe denoncimin e mekanizmave që shkaktojnë censurimin e lirisë së medias për të raportuar në mënyrë të pavarur aktivitetin qeveritar dhe të partive politike. Kjo është bërë e mundur përmes monitorimit të kanaleve televizive kombëtare, si dhe intervistave dhe fokus grupeve me gazetarë në të gjithë vendin për të matur nivelin e lajmeve të gatshme të transmetuara në mediat vizive. Të dhënat dhe dëshmitë për këtë fenomen do të publikohen në një raport në fund të projektit.



Lëvizja Evropiane në Shqipëri, përmes Portalit Online 'EuroSpeak', po mbulon disa nga temat më të rëndësishme mbi politikat e BE-së dhe procesin e integrimit të vendit tonë, të paraqitura në formën e artikujve, info-grafikëve, videove dhe përmbledhjeve të përgatitura nga ekspertë të medias dhe çështjeve të integrimit. Përveç informimit të qytetarëve shqiptarë për këto çështje, portali ofron një analizë të pavarur e cila shkon përtej renditjes së fakteve ose deklaratave të politizuara.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit përmes punës së tij po ndikon në hartimin dhe zbatimin e politikave anti-korrupsion, strategjive dhe planeve të veprimit që kanë të bëjnë me korrupsionin si dhe me sistemet/mekanizmat e parandalimit të korrupsionit në nivel lokal. KSHH po rrit ndërgjegjësimin dhe po informon punonjësit në dhjetë bashki të vendit mbi dispozitat ligjore për sinjalizuesit, dhe po kontribuon në rritjen e bashkëpunimit midis këtyre bashkive dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për të trajtuar rastet në mënyrë efektive dhe objektive.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim po kryen "Monitorimin civil të transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e vetëqeverisjes lokale" në dymbëdhjetë bashki. Duke punuar me OSHC-të lokale përmes forcimit të kapaciteteve monitoruese dhe rolit të tyre si vëzhgues të korrupsionit, projekti po kontribuon në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së bashkive, duke përdorur një sistem matjeje të transparencës dhe llogaridhënies të përgatitur dhe zbatuar enkas për këtë qëllim.

REC Shqipëri ka krijuar rrjetin NET-CLIMATE, si një mjet për aktivistët e ndryshimeve klimatike në Shqipëri për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në politikëbërjen dhe në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë nën Veprimin Global për Ndryshimet Klimatike. Përmes rrjetit, 27 nisma lokale janë botuar si "Iniciativa me shkarkim të ulët të karbonit" dhe janë promovuar si modele për t'u replikuar më tej. Një komponent i rëndësishëm i projektit është edukimi mbi ndryshimet klimatike, përmes të cilit mësuesit dhe studentët po informohen dhe përfshihen në aktivitete konkrete mbi këtë çështje.

Qendra Sociale Murialdo po kontribuon në integrimin social-ekonomik të komunitetit rom, me një fokus të veçantë tek gratë dhe fëmijët. Njëzet gra po trajnohen dhe aftësohen për prodhimin e tekstilit, si një mënyrë e vetëpunësimit dhe gjenerimit të të ardhurave për to dhe për familjet e tyre. Gra të tjera nga komuniteti janë përfshirë në kurse të tjera ndihmëse, ndërkohë që fëmijët dhe të rinjtë janë përfshirë në arsim joformal dhe aktivitete sportive në grupe me fëmijë të tjerë jo-romë duke rritur dialogun ndër-kulturor dhe integrimin e tyre.

URA BASHKËPUNIMI: SHOQËRIA CIVILE DHE SEKTORI PUBLIK PËR NJË SHOQËRI CIVILE TË QENDRUESHME

Shkurt 2020, Sesoni i parë i programit të trajnimit

Mars 2020, Trajnim Intensiv

Që prej dhjetorit 2018, Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki zbatuan këtë iniciativë duke kontribuar në përmirësimin e klimës së bashkëpunimit dhe partneritetit midis sektorëve jofitimprurës, publik dhe atij privat, për të mbështetur qëndrueshmërinë e sektorit jofitimprurës.

14 OSHC të mbështetura përmes një programi individual trainimi dhe asistence teknike zhvilluan modele biznesi për organizatat e tyre dhe ndërtuan partneritete me institucionet publike në nivel vendor (angazhimi i katër bashkive në vend - Tiranë, Elbasan, Fier, dhe Durrës), dhe me sektorin privat. Ndër modelet që u zhvilluan ishin shërbimet e integrimit për gratë viktima të dhunës, këshillimi ligjor për njësitë e vetëqeverisjes lokale, këshillimi ligjor për konsumatorët, krijimi i një muzeu virtual të vlerave dhe traditës shqiptare, si dhe shërbime që fokusojnë dhe synojnë angazhimin e të rinjve.

Gjithashtu, OShC-të pjesëmarrëse rritën njohuritë rreth çështjeve të tjera që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e tyre, si Crowdfunding, Ngritja e fondeve, dhe Sipërmarrjet Sociale.

Partnerët Shqipëri organizoi shtatë takime diskutimi dhe rrjetëzimi mes OSHC-ve pjesëmarrëse në program dhe organizatave që kanë zhvilluar me sukses modele biznesi, duke krijuar mundësinë që pjesëmarrësit në program të njihen me procesin e krijimit të një sipërmarrjeje sociale, arritjet dhe sfidat e ndeshura gjatë këtij udhëtimi.

Në kuadër të kësaj iniciative, Partnerët Shqipëri përgatiti një studim që prezanton konceptin e ri për Shqipërinë, të mekanizmit të shpërndarjes së taksave si një model i qendrueshëm për forcimin e sektorit të OSHC-ve, përmirësimin e imazhit të tij, rritjen e besueshmërisë së publikut dhe qendrueshmërisë financiare. Në të analizohen modelet dhe praktikat më të mira të vendeve të Evropës Juglindore dhe jo vetëm, të cilat kanë qenë pionere të aplikimit të këtij mekanizmi.

PARTNERËT SHQIPËRI, PJESË E DISKUTIMEVE NË SAMITIN E OSHC-VE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Juliana Hoxha, Drejtore e Partnerëve Shqipëri, ishte pjesë e diskutimeve të Samitit të OShC-VE të Ballkanit Perëndimor të organizuar nga Western Balkans Fund në 27-29 shkurt. Samiti mblodhi përfaqësues të shoqërisë civile nga i gjithë Ballkani, përfaqësues të qeverisë, donatorë dhe institucione të bashkëpunimit rajonal të cilët diskutuan mbi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si një faktor kyç për pajtimin dhe prosperitetin ekonomik.

FORUMI RAJONAL I SHOQËRISË CIVILE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

Në janar 2020, TACSO 3 organizoi në Shkup Forumin Rajonal të Shoqërisë Civile me pjesëmarrjen e rreth 110 përfaqësuesve të OSHC-ve nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, si dhe përfaqësues të lartë nga Komisioni Evropian dhe institucionet publike në rajon.

Përfaqësuesit e Komisionit Evropian prezantuan për herë të parë arkitekturën e Instrumentit të ri të Para-Anëtarësimit në BE-së për periudhën buxhetore 2021-2027 (IPA III) duke hapur kështu një proces konsultimi me OSHC-të mbi rekomandimet e tyre për mbështetjen në të ardhmen dhe përdorimin e fondeve të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe rreth 10 organizata të shoqërisë civile nga Shqipëria, morën pjesë në këtë event duke e shfrytëzuar si një mundësi për të ngritur çështje të rëndësishme në lidhje me zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në rajon.

KONKURSI I BIZNESEVE TË GJELBËRTA 2020

Prej vitit 2012 Partnerët Shqipëri organizon **Konkursin e Bizneseve të Gjelbërta.** Përmes mbështetjes së nismave inovatore që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik lokal, Konkursi synon të kontribuojë në mënyrë thelbësore në ndërtimin e një rajoni të begatë, konkurrues dhe të paqtë të Ballkanit, në linjë me 7 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Axhendës 2030.

Në vitin 2020, organizimi i Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta u mbështet nga Fondi Rockefeller Brothers dhe Credins Bank. Njëzetë finalistë të përzgjedhur nga 41 konkurrentë nga biznesi i vogël në vend, organizata jofitimprurëse, sipërmarrje sociale, dhe individë, prezantuan idetë e tyre gjatë dy ditëve të konkursit që u zhvillua në maj.

Bizneset fituese të Konkursit për vitin 2020

Fasha 1: Ide biznesi në fazë konceptuale

Rinora Handmade është një biznes për prodhimin e sapunit artizanal dhe sfungjerit bimor luffa. Produktet e Rinora Handmade janë tashmë prezente në treg, dhe 10% e fitimit nga shitja e tyre shkon në mbështetje të viktimave të dhunës.

Julvin Marku prodhon vaj organik nga frutat e çertifikuara të lajthisë, si dhe po bashkëpunon edhe me fermerë të tjerë në zonën e Thumanës, Fushë - Krujë, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik lokal.

Ruajtja e zanatit tradicional të punimit me filigran, si dhe trajnimi dhe punësimi i grave nga zonat rurale të Shkodrës dhe Vaut të Dejës është në themel të veprimtarisë së **Margjelo Filigran Albania**, një sipërmarrje sociale që prodhon objekte dekorative, suvenire dhe bizhuteri.

Fasha 2: Biznes në fazat e para të zhvillimit

Kroi i Mjaltit është biznesi i ngritur nga Besart Lama në fshatin Shullazë, Kurbin. Përvec prodhimit të mjaltit cilësor dhe nënprodukteve si qumësht blete, hoje etj. ky biznes synon të ndikojë edhe në rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore në zonë. Përmes mbështetjes së Partnerëve Shqipëri, vetëm në gjashtë muajt e parë biznesi rriti prodhimin me 40%, duke zgjeruar tregun edhe jashtë Shqipërisë.

EMBRACE - MODELE SIPËRMARRJEJE QË NDËRTOJNË MARRËDHËNIE DHE EKONOMI KRIJUESE

Viti 2020 shënoi një vëmendje të shtuar lidhur me zhvillimin e sipërmarrjes sociale në Shqipëri dhe kontributin e SS-ve në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Partnerët Shqipëri kontribuoi në zhvillimin e modeleve të biznesit për 21 SS të reja dhe ekzistuese nga i gjithë vendi, duke i orientuar ato drejt maksimizimit të të ardhurave dhe ndikimit të tyre në integrimin shoqëror dhe punësimin e grupeve të margjinalizuara të cilave u shërbejnë, për të nxitur transformime shoqërore në këto komunitete.

Aftësitë e biznesit të zhvilluara përmes programeve të ndryshme për ndërtimin e kapaciteteve dhe asistencës teknike, të kombinuara me financim dhe ekspozim ndaj një komuniteti më të gjerë të sipërmarrësve socialë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, kontribuan në përmirësimin e aktivitetit të këtyre 21 OShC-ve të angazhuara në fushën e sipërmarrjes sociale.

Në vitin e tij të tretë, EMBRACE mbështeti katër sipërmarrje të reja sociale të ngritura në Shkodër, Fier dhe Tiranë, duke arritur një numër prej 15 sipërmarrjesh sociale të mbështetura nga programi. Këto sipërmarrje të reja të fokusuara në zhvillimin e turizmit, promovimin e produkteve artizanale, shërbimet e pastrimit dhe bioproduktet lokale, kontribuan në punësimin e 4 të rinjve në turizëm, 2 individëve nga komuniteti rom dhe 2 grave nga familje me të ardhura të ulëta.

Në kohën kur komunitetet e margjinalizuara po përballen me efektet e COVID-19, sipërmarrjet e mbështetura nga EMBRACE kontribuan në:

TRAJNIM – për ➪13 të rinj si guida turistike, ➪102 fëmijë për turizmin në natyrë ➪20 gra në institucionet e riedukimit lidhur me prodhimin e produkteve artizanale, ➪200 nëna dhe ➪200 fëmijë lidhur me ushqyerjen e shëndetshme.

PROMOVIM – ➪të 5 sipërmarrjeve në sektorin e turizmit në Shkodër.

MBËSHTETJE – për ➪200 gra prodhuese nga zonat rurale përmes blerjes së produkteve të tyre.

SHËRBIME – për ➪150 gra viktima të trafikimit dhe dhunës në familje, përmes të ardhurave të gjeneruara nga SS.

PËRDORIMI SOCIAL I PRONAVE TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR

Pas një udhëtimi katër vjeçar, finalizuam **C.A.U.S.E. – Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale**, iniciativën e parë të zbatuar në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor, e cila krijoi një model të ri-përdorimit të qëndrueshëm të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar, duke i shndërruar ato në sipërmarrje sociale të administruara nga organizatat e shoqërisë civile. ***Pastiçeria Sociale KeBuono*** në Fier, ***Kafe Librari KinFolk*** në Durrës dhe ***Garazhi Social i Artizanatit*** në Sarandë, janë tre sipërmarrjet e para sociale të ngritura në prona të konfiskuara, që ofrojnë mundësi edukimi, punësimi dhe riintegrimi për individët e prekur ose në rrezik të preken nga aktiviteti kriminal siç janë gratë dhe vajzat viktima të trafikimit dhe dhunës në familje, dhe të rinjtë në shërbimin e provës ose që vijnë nga grupe të margjinalizuara.

Inaugurimi i Garazhdit Social të Artizanatit, 7 shkurt '20

Këto sipërmarrje sociale i shërbejnë komunitetit në përgjithësi duke ofruar produktet dhe shërbimet e tyre dhe duke përcjellë mesazhe besimi tek institucionet, dhe janë një provë e gjallë që çka i është marrë komunitetit mund t'i kthehet atij falë përpjekjeve dhe bashkëpunimit të të gjithë aktorëve të shoqërisë.

Mesazhe të tilla u përcollën në konferencën përmbyllëse të projektit, ku një diskutim i nivelit të lartë të aktorëve kryesorë të përfshirë në këtë iniciativë, theksoi rëndësinë e ri-përdorimit social të pasurive të konfiskuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe nevojën për mbështetje të iniciativave të tilla në të ardhmen. C.A.U.S.E. u zbatua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Në vijim të përpjekjeve për të standardizuar dhe promovuar këtë praktikë të vendosur nga Partnerët Shqipëri, me mbështetjen e Programit të Granteve të Vogla të Komisionit të Demokracisë të Ambasadës Amerikane në Tiranë, gjatë këtij viti kryem një fushatë të gjerë informuese dhe ndërgjegjësuese mbi ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar.

Në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përgatitëm **Udhëzuesin Praktik për OJF-të: Ngritja e Sipërmarrjeve Sociale në Prona të Konfiskuara nga Krimi i Organizuar**, i cili ofron informacion mbi bazën ligjore dhe institucionet përgjegjëse, përshkruan procesin, ofron shembuj konkretë dhe formate standarde për të ndihmuar të gjitha OJF-të në përpjekjet e tyre për të ngritur një sipërmarrje sociale në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar, shoqëruar me një spot sensibilizimi të transmetuar në stacionet kryesore televizive në vend.

Roli i AAPSK-së dhe format e bashkëpunimit me të u promovuan gjithashtu përmes një spoti sensibilizues, si dhe një dokumentari që paraqet mundësitë dhe rëndësinë e ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar nga OSHC-të, si forma më e vlefshme për të afirmuar vlerën e ligjshmërisë dhe iniciativës qytetare kundër krimit të organizuar.

Pjesë e fushatës ishte gjithashtu një diskutim i përbashkët me organizatat e shoqërisë civile të përfshira në aspekte të ndryshme të luftës kundër krimit të organizuar, si ndërgjegjësimi dhe monitorimi, media investigative, ofrimi i shërbimeve për viktimat e krimit, etj. Ky diskutim i zhvilluar në prani të AAPSK-së, shërbeu për të nxjerrë në pah rolin dhe kontributin e padiskutueshëm të organizatave të shoqërisë civile në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe për të paraqitur perspektivat e tyre mbi ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara si një model i ri në mbështetje të komuniteteve lokale dhe në ndërtimin e besimit të qytetarëve në drejtësi.





Gjatë prezantimit të *Udhëzuesit Praktik për OJF-të: Ngritja e Sipërmarrjeve Sociale në Prona të Konfiskuara nga Krimi i Organizuar*, dhe hapave të nevojshëm që organizatat duhet të ndjekin në ndërmarrjen e nismave të tilla.

Jehona e kësaj iniciative të Partnerëve Shqipëri ka kaluar përtej kufijve kombëtarë, dhe po prezantohet e promovohet gjerësisht si një model i suksesshëm për tu ndjekur edhe nga vendet e tjera të rajonit.



Nga webinari i organizuar nga Project Ahead me organizatat në Itali, ku Klotilda Kosta, Drejtore e Programeve e PSH ndau modelin shqiptar të ri-përdorimit të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar për qëllime sociale.

Nga workshopet e OSBE-së për adresimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes ri-përdorimit të pasurive të konfiskuara në Shqipëri, pjesë e një serie workshopesh të organizuara në kuadër të një iniciative rajonale të OSBE-së për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar në Evropën Jug-Lindore (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi dhe Serbi) përmes përmirësimit të bashkëpunimit rajonal në konfiskimin, menaxhimin dhe ri-përdorimin e pasurive të konfiskuara.

RISE-ALB, FORCIMI I SIPËRMARRJES SOCIALE NË SHQIPËRI

Në vitin 2020, Partnerët Shqipëri në partneritet me ENGIM Internazionale filluan projektin RISE-ALB mbështetur nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.
Projekti synon zhvillimin e sipërmarrjeve sociale, si një mjet për të përmirësuar përfshirjen socio-ekonomike të grupeve të disadvantazhuara.

Partnerët Shqipëri përgatiti një studim fillestar rreth zhvillimeve dhe nevojave më të fundit të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, i cili shërbeu si një kontribut për të hartuar komponentë të tjerë të projektit.





Një nga gjetjet e studimit fillestar ishte se sipërmarrjet sociale varen vetëm nga burimet tradicionale të financimit të tilla si grantet dhe shitjet. Për këtë arsye, Partnerët Shqipëri përgatiti gjithashtu një material që paraqet mekanizmat financiarë alternativë siç janë engjëjt e biznesit dhe firmat e kapitalit sipërmarrës, duke synuar rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin e SS-ve në këtë drejtim. Të dy këto botime u ndanë në katër tryeza të rrumbullakëta me praktikues, vendimmarrës dhe organizata mbështetëse në fushën e sipërmarrjes sociale.

DUA PARTNER INVEST

www.duapartnerinvest.com

Partnerët Shqipëri ka mbi një dekadë përvojë në zhvillimin dhe mbështetjen e ekosistemit të sipërmarrjes përmes kërkimit, advokimit, financimit, ekspertizës dhe krijimit të mundësive të rrjetëzimit.

Platforma **Dua Partner Invest** është ndërmarrja më e re e Partnerëve Shqipëri në fushën e sipërmarrjes dhe inovacionit, në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm. Ajo shërben si një hub virtual për komunitetin e sipërmarrësve nga Ballkani Perëndimor, për të rritur bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe qasjen në financime.

Dua Partner Invest ndihmon në kapërcimin me sukses të barrierave në qasjen e fondeve duke përbërë një qendër ku kryqëzohen talente të rinj premtues të cilët ndeshen me sfidën e vazhdueshme të sigurimit të fondeve për të vënë idetë e tyre në praktikë.

Platforma funksionon si një trekëndësh i përbërë nga *konsulentë*, *investitorë* dhe *sipërmarrës* nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor.

DISKUTIM I NIVELIT EVROPIAN MBI EKONOMINË SOCIALE DHE SIPËRMARRJET SOCIALE

Partnerët Shqipëri është anëtare e DIESIS, një nga rrjetet më të mëdha evropiane të specializuara në mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë sociale, sipërmarrjes dhe inovacionit social, përmes trajnimit, hartimit të projektit, shërbimeve këshilluese, ndihmës teknike dhe kërkimit. Në shkurt, anëtarët e rrjetit u mblodhën në Bruksel për të diskutuar strategjinë e re të Komisionit për ekonominë sociale dhe sipërmarrjet sociale.

DIESIS POLICY LAB

Në 12 nëntor '20, u mbajt workshopi i parë i serisë #DiesisPolicyLab fokusuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku në qendër të tij kishte forcimin e ekosistemit të ekonomisë sociale dhe bashkëpunimin rajonal.

Partnerët Shqipëri dhe organizata të tjera anëtare të Diesis që mbështesin sipërmarrjen sociale nga Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnje & Hercegovina, së bashku me përfaqësuesin e DG pranë Komisionit Evropian, udhëhoqën diskutimin mbi gjendjen e ekonomisë sociale në rajon, si në aspektin e situatës së pandemisë COVID-19 ashtu edhe në fokusin e marrëdhënieve BE-Ballkani Perëndimor.

Si pjesë e diskutimit të saj, Drejtorja e Partnerëve Shqipëri Juliana Hoxha, ndau disa rekomandime për Komisionin Evropian lidhur me skemat e financimit që përfshijnë Shqipërinë, që të jenë më të aksesueshme, diverse dhe më përfshirëse për të gjitha llojet e sipërmarrjeve sociale që operojnë në Shqipëri.

PARTNERËT SHQIPËRI, PJESË E KONFERENCËS "DIASPORA FLET"

Erila Haska, Menaxhere Programi e Partnerëve Shqipëri ishte një nga folëset në konferencën Diaspora Flet 2021 të organizuar nga GERMIN. Konferenca mblodhi së bashku 2800 individë nga diaspora të cilët diskutuan për çështje të ngutshme të kombit, dhe ndanë përvojën e tyre të suksesshme në vendet ku jetojnë. Znj. Haska prezantoi mbështetjen që Partnerët Shqipëri ka ofruar për ekosistemin e sipërmarrjes sociale, si dhe iniciativën më të fundit të organizatës në mbështetje të komunitetit të startupeve - platformën Dua Partner Invest.



STUDIM MBI NDIKIMIN E NISMËS SË KOMISIONIT EVROPIAN PËR BIZNESIN SOCIAL

Partnerët Shqipëri kontribuoi në Studimin mbi Ndikimin e Nismës së Komisionit Evropian për Biznesin Social dhe aksionet në vijim. Studimi i porositur nga Komisioni Evropian ofron një analizë gjithëpërfshirëse të bazuar në fakte, të ndikimit të kësaj iniciative si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë të BE-së. Ai përfshin një analizë të nevojave aktuale dhe përfundon me ofrimin e opsioneve për iniciativa të ardhshme në fushën e politikave.

PËR NJË TREG PUNE NË DOBI TË RINISË SHQIPTARE

RisiAlbania është një projekt zhvillimor që synon rritjen e shanseve për punësim të të rinjve. Ai është një projekt i Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga një konsorcium partnerësh të përbërë nga Helvetas Swiss Intercooperation dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

Vizitoni www.risialbania.al për të mësuar më shumë mbi punën e RisiAlbania



KËSHILLIMI I KARRIERËS - NJË MODEL PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR TË RINJTË NË NIVEL VENDOR

Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me RisiAlbania po punon për të advokuar për krijimin e këshillimit të karrierës si shërbim të ofruar në nivel bashkiak në Shqipëri. Kjo iniciativë është pjesë e strategjisë së RisiAlbania për të përmirësuar shërbimet e karrierës në Shqipëri, me një fokus të veçantë tek të rinjtë. Modeli aktualisht po pilotohet në Bashkinë e Tiranës.
Nisma konsiston në një lëvizje rinore nga poshtë lart, e cila advokon për rëndësinë e shërbimeve të këshillimit të karrierës tek të rinjtë dhe vendimmarrësit në nivelin vendor. Gjatë vitit 2020, Partnerët Shqipëri lehtësoi punën e nëntë koalicioneve të 27 organizatave rinore në nëntë qytete dhe i ndihmoi ata për të hartuar dhe zbatuar fushata advokuese në bashkitë përkatëse, për të takuar të rinjtë në qytetet e tyre dhe për të diskutuar me ta çështje në lidhje me arsimimin, trajnimin dhe zgjedhjet e tyre profesionale.



ÇMIMI I FILANTROPISË

Një nga aktivitetet më të spikatura të Partnerëve Shqipëri në fushën e filantropisë është **Çmimi Filantropisë** që organizohet prej vitit 2011, një event i përvitshëm për të shprehur vlerësimin dhe mirënjohjen për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës në shoqërinë tonë.

Më 7 shkurt, në prani të të ftuarve të nderuar nga qeveria dhe parlamenti, institucionet ndërkombëtare dhe agjencitë donatore, sektori i biznesit, organizatat jofitimprurëse, media dhe trupat diplomatikë të akredituar në vendin tonë, Partnerët Shqipëri prezantoi **Çmimet e Filantropisë 2019**.

Çmimi për Kontributin në Nivel Kombëtar iu akordua ***SIGAL UNIQA Group AUSTRIA*** me motivacion: Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjedis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve, ku veçohen: Klinika Lëvizëse Mjekësore në shkallë vendi, rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar "Matosh UKA" në Fierzë, Tropojë dhe Pallatit të Sportit Përmet, si dhe krijimi i Klubit "Art dhe Kulturë" në dispozicion për të gjithë qytetarët e Durrësit".
Çmimi u dorëzua nga Znj. Anila Denaj , Ministre e Financave dhe Ekonomisë.

Çmimi për Kontributin në Nivel Lokal iu akordua Kompanisë ***Mrizi i Zanave***, me motivacion: Për kontributin e dhënë në promovimin dhe zhvillimin e vlerave tradicionale të zonës së Fishtës, Lezhë, duke e kthyer atë në një atraksion turistik dhe destinacion kulinar të mbështetur fort në zhvillimin e ekonomisë familjare dhe punësimin e banorëve të zonës.
Çmimi u dorëzua nga Z. Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania.



Çmimi për Kontributin si Individ iu akordua ***Zj. Suela Bala***, me motivacion: Për iniciativën e organizimit të "Bibliotekës Lëvizëse", si një platformë edukuese dhe një dritare integruese për fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet librit në bashkinë e Lezhës, duke krijuar një model të suksesshëm që u shndërrua në një lëvizje gjithëpërfshirëse në të gjithë vendin.
Çmimi u dorëzua nga Sh.T. Z. Luigi Soreca, Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Çmimi – Pionieri i Filantropisë iu akordua ***Z. Hamza Rama*** (pas vdekjes), me motivacion: Për ndihmën bujare dhe kontributin e çmuar në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve shëndetësore të qytetarëve dhe familjeve në nevojë në qytetin e Lezhës dhe fshatrat përreth, si dhe për mbështetjen financiare të klubit sportiv "Bardhyli" të Lezhës.
Çmimi u dorëzua nga Znj. Mira Rakacolli, Zv. Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Çmimi i Mirënjohjes për Angazhim Qytetar iu akordua ***Zj. Delina Fico***, me motivacion: Për kontributin e çmuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kauzave të ndryshme sociale në vend, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të grave e vajzave dhe promovimin e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare.
Çmimi u dorëzua nga Zj. Marinela Jazoj, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Investitorëve të Huaj në Shqipëri dhe Konsulle Nderi e Norvegjisë.

Çmim Special iu akordua ***Z. Arben Cara*** me motivacion: Për kryerjen me heroizëm dhe devotshmëri maksimale të detyrës së zjarrëfikësit në përpjekjet e kërkim-shpëtimit të jetëve të prekura nga tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit 2019, duke vënë në plan të parë misionin e profesionit edhe në kushtet më ekstreme të rrethanave personale.

Çmim Special iu akordua ***Komunës së Prizrenit***, me motivacion: Për ndihmën bujare dhe të pakushtëzuar në pritjen dhe strehimin e qytetarëve shqiptarë të dëmtuar nga tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit 2019, pjesë e mbështetjes dhe solidaritetit të jashtëzakonshëm të popullit vëlla dhe institucioneve të Kosovës."

Çmimet Speciale u dorëzuan nga Z. Petro Koçi, Zv. Ministër i Mbrojtjes.

MONITORIMI I AKTIVITETIT FILANTROPIK

Viti 2020 ishte fatkeqësisht sërish një vit i vështirë për shkak të pandemisë globale Covid-19. Kjo situatë ndryshoi përgjithmonë mënyrën tonë të të jetuarit, na prezantoi me një realitet të ri dhe na rikujtoi sërish rëndësinë e filantropisë, solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë që mundësuan zbutjen e pasojave dhe ofrimin e një burimi mbështetjeje për të gjithë personat e prekur drejtpërdrejtë apo tërthorazi.

Përmes një monitorimi të kujdesshëm ditor të dhurimeve, fushatave dhe eventeve të publikuara në media të ndryshme, media sociale, faqet e internetit të institucioneve publike dhe jopublike, gjatë vitit 2020 u identifikuan 432 raporte dhurimesh me një shumë prej 103,688,004 Lekë (844,411 Euro).

Përfituesit





Fushat e dhurimit



Numri i dhurimeve

JAVA E FILANTROPISË 2020

Partnerët Shqipëri prezantoi në vitin 2020 **Javën e Filantropisë**! Një seri eventesh u zhvilluan nga 9-13 nëntor, duke përfshirë një fushatë ndërgjegjësimi online dhe promovimin e figurave filantropike ndër vite, forume diskutimi me studentë, biznese, OJF, e individë, si dhe disa diskutime në media rreth temës dhe eventeve të javës.









LEVIZ ALBANIA

www.levizalbania.al

LevizAlbania është një projekt që synon të forcojë demokracinë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë për një qeverisje vendore cilësore. LevizAlbania është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare të suksesshme: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, dhe Co-Plan.

Në cilësinë e saj si anëtare e konsorciumit, Partnerët Shqipëri zbaton drejtpërdrejti dy ndërhyrje strategjike në mbështetje të punës së LevizAlbania, si pjesë e Shërbimeve Mbështetëse me Vlerë të Shtuar (VASS). E para vjen në mbështetje të përfituesve të granteve të LevizAlbania për zbatimin efektiv të projekteve të tyre, dhe e dyta fokusohet në mobilizimin e të rinjve rreth çështjeve të demokracisë vendore.

22 përfitues të granteve të LevizAlbania, OShC dhe individë, morën pjesë në tre sesione tematike rrjetëzimi, të cilat u mundësuan atyre të ndajnë me njëritjetrin planet, objektivat, dhe iniciativat në zbatim. Diskutimi gjithashtu ndihmoi në gjetjen e hapësirës për aksione të përbashkëta advokuese dhe koordinim në terren.



Për të adresuar sfidat e COVID-19 në ofrimin e shërbimeve për mbështetësit e tyre, programi kontribuoi në rritjen e njohurive dhe aftësive të përfituesve të LevizAlbania në përdorimin e teknologjisë dighitale për të mësuarit online dhe pjesëmarrjen e komunitetit përmes këtyre teknologjive.

16 përfitues të granteve të LevizAlbania morën pjesë në 32 ditë sesione mentorimi për zhvillimin e programeve të trajnimit në fushën e advokacisë dhe lobimit për përfituesit e tyre, ndërtimin e urave të bashkëpunimit me njësitë e vetë-qeverisjes lokale, përmirësimin e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve për informimin publik, orientimin se si dhe ku të kërkojnë këshillim ligjor lidhur me aksionet e tyre, etj.

Lëvizja Rinore - Një faqe e re për komunitetet lokale është një iniciativë tjetër e Partnerëve Shqipëri në kuadër të programit VASS të LevizAlbania, që synon të krijojë një lëvizje të të rinjve në të gjithë vendin, të cilët përmes angazhimit të tyre qytetar dhe punës vullnetare të kontribuojnë për komunitete më të forta dhe një pushtet vendor më të përgjegjshëm.

Gjatë vitit 2020 u organizuan **12 kampe rinore**, me pjesëmarrjen e **158 të rinjve**, nxënës të shkollave të mesme nga Vlora, Shkodra, Durrësi, Pogradeci, Elbasani dhe Tirana.

Ata zbatuan **12 iniciativa**, duke shërbyer si model se si të rinjtë mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në adresimin e çështjeve në komunitetet e tyre.

Në kuadër të **Javës së Demokracisë Vendore** të LevizAlbania gjatë 12-16 tetorit 2020, Partnerët Shqipëri organizoi eventin "**Të Rinjtë Flasin**" me pjesëmarrjen e të rinjve nga shkollat e mesme të Vlorës dhe Shkodrës. Në event morën pjesë përfaqësues nga bashkitë e Shkodrës dhe Vlorës, organizata të shoqërisë civile, media, akademia, etj.

Të katër ekipet fituese nga kampet e të rinjve, ndanë me të ftuarit përvojat, sfidat, mësimet e nxjerra, arritjet dhe planet e ardhshme se si synojnë të qëndrojnë të angazhuar në komunitetet e tyre si në shkollë ashtu edhe aty ku banojnë.

Nga kampet rinore me nxënës të shkollave nga Vlora, Shkodra, Durrësi, Pogradeci, Elbasani dhe Tirana. Si pasojë e Covid-19, disa nga kampet u zhvilluan online.









HUB-I RINOR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

Që prej vitit 2016, Partnerët Shqipëri është pjesë e Hubit Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, një rrjet prej 20 organizatash rinore që punojnë për të kontribuar në një përfshirje më të madhe të të rinjve në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë dhe Turqinë. Qëllimi i rrjetit është të nxisë përfshirjen sociale, ekonomike dhe politike të të rinjve përmes zbatimit të iniciativave advokuese në fushën e politikave, përmes partneritetit me palët e interesit dhe përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese.

Në Mars 2020, Rrjeti filloi zbatimin e iniciativës **Ballkani Perëndimor & Turqia për Punësimin Rinor** (***WB & T for EmploYouth***)e cila synon të krijojë zgjidhje të informuara për përmirësimin e politikave të punësimit të të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Përkrah advokimit bazuar në fakte, projekti synon të ndërtojë kapacitetet e organizatave komunitare në zonat rurale, për të gjeneruar ide inovatore duke kontribuar në rritjen e mundësive të punësimit për të rinjtë në NEET. Për më tepër, si pjesë e nismës, rrjeti do të ofrojë mbështetje financiare për 10 organizata për të vënë në veprim idetë e tyre.

Në javën e 8-15 Dhjetorit, rrjeti organizoi një fushatë online në të gjitha vendet anëtare, për të prezantuar gjetjet kryesore të Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore për vitin 2019, duke paraqitur situatën aktuale në lidhje me pjesëmarrjen politike, shoqërore dhe ekonomike të të rinjve. Raporti i Indeksit të Pjesëmarrjes Rinore shërben si një udhëzues për rekomandimet në fushën e politikave dhe iniciativat advokuese të rrjetit në lidhje me pjesëmarrjen rinore. Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian.

AKADEMIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE NEGOCIATAVE

Që prej vitit 2019, AIEN në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri po zbaton "Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave". Përmes edukimit dhe trajnimit, Akademia synon të kontribuojë në përgatitjen e një Shqipërie Evropiane, bazuar në parimet e respektimit të shtetit të së drejtës, të të drejtave të njeriut, lirisë, sipërmarrjes së lirë ekonomike, solidaritetit dhe pjesëmarrjes qytetare.
Pjesëmarrës nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, organizatat e biznesit dhe media, filluan në tetor rrugëtimin e tyre në edicionin e dytë të Akademisë, konceptuar në 12 module të ndryshme ndërvepruese.

Në eventin e nisjes së programit, Partnerët Shqipëri si një prej organizatave zbatuese, prezantoi studimin e kryer më herët "Shoqëria Civile dhe Procesi i Integrimit të Shqipërisë në BE - Një vlerësim i ndërsjellë i kapaciteteve të OShC-ve dhe gatishmërisë së institucioneve për të kryer një proces gjithëpërfshirës".

AIEN mbështetet nga Njësia Qendrore e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) në Shqipëri.

PRAKTIKAT MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Partnerët Shqipëri dhe UNDP Shqipëri organizuan Konkursin Kombëtar "Praktikat më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror". Ky event shërbeu për të prezantuar dhe promovuar 15 praktikat më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të ofruara nga qendrat e kujdesit shoqëror të bashkive dhe organizatat e shoqërisë civile.

Praktikat u përzgjodhën përmes një procesi konkurues në të cilin u ftuan të marrin pjesë rreth 200 ofrues shërbimesh, dhe u vlerësuan në bazë të disa kritereve si cilësia dhe përshtatshmëria e shërbimit, inovacioni, rezultatet, qendrueshmëria, bashkëpunimi me aktorë të tjerë, mundësia për përshkallëzim, etj.

Në fund të aktivitetit, një juri me anëtarë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme - Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Fakulteti i Shkencave Sociale- Departamenti i Punës Sociale, UNDP dhe programi "Asnjë të mos mbetet pas", vlerësoi me çmime gjashtë praktikat më të mira ndër 15 praktikat e prezantuara.

Këto praktika janë botuar në *Katalogun e Praktikave më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*.

PUBLIKIME

Ky raport paraqet gjetjet e vlerësimit që Partnerët Shqipëri kreu menjëherë pas emergjencës së COVID-19 në mars '20, për të parë ndikimin e situatës në veprimtarinë e sektorit, nevojat lidhur me adaptimet kontraktuale me donatorët për aktivitetet në vijim, si dhe nevojat specifike lidhur me aksesin dhe aftësitë për të orientuar ofrimin e shërbimeve online.

Raporti prezanton gjetjet e matjes së kuadrit mundësues ligjor dhe praktik për zhvillimin e shoqërisë civile.

Ky është raporti i 7-të i kryer në Shqipëri dhe është pjesë e një serie raportesh nga shtatë vende të Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi.



Partnerët Shqipëri u zgjodh për të përgatitur rastin studimor për Shqipërinë lidhur me efektivitetin në përgjigjen ndaj COVID-19. Ky studim ishte pjesë e një përpjekjeje globale të ndërmarrë nga CSO Partnership for Development Effectiveness, për evidentimin e zbatimit të parimeve të bashkëpunimit efektiv të zhvillimit në strategjitë dhe politikat kombëtare dhe sektoriale në reagimin ndaj COVID-19.



Karakteristikat dhe sfidat e sipërmarrjeve sociale në Shqipëri eksploron karakteristikat e SS-ve në Shqipëri sipas tre parimeve kryesore: dimensioni social, dimensioni ekonomik dhe struktura qeverisëse, dhe prezanton sfidat dhe nevojat që ato kanë për zhvillimin e tyre.

Kjo broshurë informuese paraqet rrugëtimin e sipërmarrjeve sociale të mbështetura përmes një programi ndërtimi kapacitetesh, mbështetjeje financiare, rrjetëzimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërtimi të partneriteteve me biznesin, proceseve të advokimit mbi kornizën ligjore dhe rregullatore në vend, etj.

Udhëzuesi Praktik për OJF-të - Ngritja e Sipërmarrjeve Sociale në Prona të Konfiskuara nga Krimi i Organizuar paraqet hapat e nevojshëm që organizatat duhet të ndjekin në ndërmarrjen e iniciativave të tilla, institucionet përgjegjëse, kornizën ligjore përkatëse, shembuj të iniciativave të suksesshme të ndërmarra, etj.

Ky studim i bazës fillestare ofron një përmbledhje të politikave për të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET), nëngrupet që përfshihen në këtë kategori dhe statistikat në lidhje me të rinjtë NEET në Shqipëri.
Studimi gjithashtu ofron një analizë të kornizës ligjore në lidhje me punësimin e të rinjve nga grupet në nevojë dhe të rinjtë NEET përfshirë strategjitë (për punësimin, rininë dhe çështjet sociale), ligjet, direktivat dhe programet / masat mbështetëse në nivel kombëtar dhe rajonal, duke paraqitur edhe cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Ky dokument prezanton konceptin e ri për Shqipërinë, të mekanizmit të shpërndarjes së taksave si një model i qendrueshëm për forcimin e sektorit të OSHC-ve, përmirësimin e imazhit të tij, rritjen e besueshmërisë së publikut dhe qendrueshmërisë financiare. Në të analizohen modelet dhe praktikat më të mira të vendeve të Evropës Juglindore dhe jo vetëm, të cilat kanë qenë pioniere të aplikimit të këtij mekanizmi.

Ky raport ofron një panoramë të situatës në lidhje me pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve bazuar në një grup treguesish të paracaktuar.
Ai shërben si udhëzues për rekomandime në fushën e politikave të cilat janë të bazuara në fakte, si dhe për iniciativa advokuese të Rrjetit Hubi Rinor lidhur me pjesëmarrjen rinore.

Ky është një raport përmbledhës i studimit "Shoqëria Civile dhe Procesi i Integrimit të Shqipërisë në BE - Një vlerësim i ndërsjellë i kapaciteteve të OShC-ve dhe gatishmërisë së institucioneve për të kryer një proces gjithëpërfshirës". Studimi u krye nga Partnerët Shqipëri në kuadrin e Akademisë së Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN).

Ky studim paraqet një përmbledhje të situatës filantropike në Shqipëri dhe pasqyron tendencat kryesore dhe praktikat më të mira nga vendet e tjera, të cilat mund të shërbejnë për një kuptim më të mirë të dinamikës nga grupet e interesit, pjesë e sektorit të organizatave filantropike.

Punimi është i strukturuar bazuar në disa nga treguesit kryesorë që përbëjnë lirinë filantropike si çështjet tatimore dhe fiskale, aktiviteti filantropik ndërkufitar, mjedisi politik në Shqipëri dhe trendet kryesore të zhvillimit të filantropisë në vend, si dhe disa praktika të mira nga vendet e tjera.

Fakte mbi Aktivitetin Filantropik pasqyron veprimtarinë filantropike në Shqipëri gjatë vitit 2020. Raporti analizon sektorët kryesorë dhe kauzat e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik dhe natyrën e donatorëve dhe përfituesve.

Ky katalog prezanton 15 praktikat më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri, të identifikuara përmes një procesi konkurues të ofruesve publikë dhe jo-publikë të shërbimeve të kujdesit shoqëror në të gjitha bashkitë e vendit.

Kjo është një broshurë e përgatitur nga Risi Albania dhe Partnerët Shqipëri, që promovon zbatimin e modelit Alberghi Diffussi në Shqipëri.



Broshura paraqet dipërmarrjet e gjelbërta të mbështetura prej vitit 2012 dhe impaktin e tyre në punësim dhe zhvillimin ekonomik.

Raporti vjetor 2019, një pasqyrë e veprimtarisë së PSH, përfituesve e mbështetësve gjatë vitit paraardhës.

Të rejat më të fundit nga PSH dhe Buletini i Qendrës Kombëtare Burimore mbulojnë një gamë të gjerë zhvillimesh në shoqërinë civile në nivel kombëtar, rajonal e global.

Një prezantim i Fituesve të **Çmimit të Filantropisë** ndër vite.

PROGRAMET E PARTNERËVE SHQIPËRI NË FOKUSIN E MEDIAS

MBËSHTETËSIT TANË

Funded by the European Union

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Norwegian Embassy

Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

Sida

SlovakAid
GOOD IDEA SLOVAKIA

CREDINS bank

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

AGENZIA ITALIANA PER LA COOPERAZIONE ALLO SVILUPPO

FINANCAT



Grant Thornton

Grant Thornton Sh.p.k.
Str. Sami Frashëri, Kompleksi T.I.C, Ndërt. 8
Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 44 520 890
M +355 69 404 700
www.grantthornton.al
contact@gt.al.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin e fondacionit "Partnerët-Shqipëri, për Ndryshim dhe Zhvillim",

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partnerëve – Shqipëri, për Ndryshim dhe Zhvillim ("me poshtë referuar si "Fondacioni" ose "Partnerët Shqipëri"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël me të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin *drejt, në të gjitha aspektet materiale*, pozicionin financiar të Fondacionit me datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e shpenzimeve sipas aktiviteteve dhe fluksetë monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatave Jo-Fitimprurëse.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-st). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Fondacioni në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), bërësat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

i



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondacionit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Fondacionin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondacionit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një sigurí të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një sigurí e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra si bashkë, priten që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe shpeticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazën e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosvepritme të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkeljе të kontrolleve të brendshme.
- marim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurat të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

ii



- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me rrjatje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojëme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë si pamjaftueshëme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, rrjatjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjeve të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
21 prill 2021

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 91923007 M Tirana ALBANIA

iii



*Buxheti i drejtpërdrejtë i manaxhuar nga Partnerët Shqipëri, pa përfshirë projektet LevizAlbania dhe RisiAlbania.

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

RAPORT VJETOR 2020

www.partnersalbania.org